



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në mbështetje të nenit 145 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 4, 21, 22 të Ligjit Nr.03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, nr.82 ,21 tetor 2010) si dhe duke u bazuar në nenin 8 (nënparagrafi 1.4) dhe Shtojcën XII të Rregullores Nr.02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011) dhe Rregullores Nr. 07/2011 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr.02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nxjerr:

VENDIM

1. Shfuqizohen Udhëzimet Administrative si në vijim:
 - 1.1. Udhëzimi Administrativ Nr. 2009/3 për Përdorimin e Automjeteve dhe Telefonave Fiks dhe Mobil nga Anëtarët e EPK-ve;
 - 1.2. Udhëzimi Administrativ Nr. 2009/4 për Udhëtime Zyrtare të Anëtarëve të EPK –ve.
2. Obligohet Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, që ta njoftoj Zyrën Ligjore të Zyrës së Kryeministrit me qëllim që Udhëzimet e lartcekura të hiqen nga regjistri i akteve nënligjore të miratuara nga Ministri.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ljubomir Marić,
Ministër i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal

Vendimi i dërgohet:

- Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL-së;
- Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave/MAPL;
- Arkivit të MAPL-së